



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PATOS
KËSHILLI I BASHKISË
KOORDINATOR I KONSULTIMIT PUBLIK

Nr. 2362 / Prot.

Patos, më 11 / 09 / 2025

PROCESVERBALI I TAKIMIT 10 SHTATOR 2025

Vendi: Salla e Këshillit Bashkiak Patos

Ora e fillimit: 13:30

Ora e mbarimit: 14:30

Dëgjese publike me temë: “Rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”.

Baza Ligjore: Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”.

Pjesëmarrës: Zv/ Kryetare e bashkisë znj. Ina Sauli, Kryetar i këshillit, z. Armand Ahmetaj, Sekretare e Këshillit znj. Refaela Xeba, Anëtarë GMS dhe përfaqësues të bashkisë Patos, të rinj të qytetit, rreth 37 pjesëmarrës (mësues, nxënës, të rinjtë etj)

Takimin hapet nga Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj

Kryetar i Këshillit z. Armand Ahmetaj- të nderuar të pranishëm! Ju falenderoj që jeni bërë



**Kryetar i Këshillit
z. Armand Ahmetaj**

**Dëgjese publike me temë:
“Rishikimi i ndryshimeve të projekt dokumentit
për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe buxhetit për
vitin 2026”
Shtator 2025**

pjesë të kësaj dëgjese publike. Në zbatim nenit 18 të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen

vendore” i ndryshuar, ligjit nr. 146/2012 “Për njoftimin dhe konsultimin publik”, ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, Rregullores së Këshillit Bashkiak “Për konsultimin publik”, si dhe VKB nr. 88, datë 19.12.2024 “Mbi miratimin e kalendarit të përgatitjes së projekt buxhetit afatmesëm 2026-2028 dhe projekt buxhetit vjetor për vitin 2026”, jemi këtu sot për të bërë një rishikim të projekt dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe për të marr edhe njëher sugjerimet tuaja lidhur mbi këtë dokument. Ju ftoj të ndjekim prezantimin e ekzekutivit dhe më pas mund të jepni sugjerimet dhe kërkesat tuaja.

Drejtores e Financave, znj. Mimoza Shtëmbari- përshëndetje të gjithëve! Në lidhje me buxhetin afatmesëm për tu parashikuar në shatator dhe kërkesat tuaja dua të them që në



**Drejtores e Financave
znj. Mimoza Shtëmbari**


Dëgjese publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-
2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

dëgjesat e para ju keni sjell disa kërkesa si pajisja e bibliotekave me libra, pajisja me mjete e laboratorëve, stolat, qendra e zërit etj. Këto kërkesa janë përmbledhur dhe janë marrë parasysh në hartimin e dokumentit. Për sa i përket shkollave dhe rikonstruksionit të tyre ne kemi projekte të ndryshme. Gjithashtu jemi duke punuar me mirëmbajtjen e shkollave. Bibliotekat shumë shpejt do të pajisen me libra sipas edhe kërkesave tuaja. Fonia është parashikuar në vitin 2026 dhe do të pajiseni. Ju mund të sillni edhe sugjerime dhe kërkesa të tjera të reja nëse keni.

Mësues në shkollën “Meleq Gosnishti”, z. Lefter Manaj- përshëndetje! Në shkollën tonë nuk ka filluar mirëmbajtja. Në shkollat e tjera, a ka përfunduar procesi i mirëmbajtjes?



**Mësues në shkollën “Meleq Gosnishti”
z. Lefter Manaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

Drejtori i Agjencisë së Shërbimeve Publike ASHP, z. Eneo Xhaferaj– Ne jemi duke punuar me të gjitha shkollat aktualisht. Kishim një vonesë në pajisjen me materiale, por po



**Drejtor
z. Eneo Xhaferaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

përpiqemi ti mbarojmë të gjitha. Disa shkolla kanë mbaruar, por shkolla juaj ka akoma edhe pak punë me mirëmbajtjen.

Mësues në shkollën “Meleq Gosnishti”, z. Lefter Manaj- Shkollja jonë ka disa probleme



**Mësues në shkollën “Meleq Gosnishti”
z. Lefter Manaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

të tjera pasi doreza e shkollës ka probleme, këndi sportiv mbrapa shkollës nuk është bërë, palestra ka probleme me lagështirën.

Drejtoresh e financave, znj. Mimoza Shtëmbari- për vitin 2026 bashkia ka disa projekte të



**Drejtoresh e financave
znj. Mimoza Shtëmbari**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-
2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

përgatitura për aplikim për shkollat dhe në ato projekte janë të përfshira edhe këndet sportive. Gjithashtu janë përfshirë edhe investimet që ju keni paraqitur edhe në dëgjuesën e parë.
Mësuese në shkollën vartëse Ofinë, znj. Donika Malaj- përshëndetje! Unë dua t'ju



**Mësuese në shkollën vartëse Ofinë
znj. Donika Malaj**

Dëgjuesë publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-
2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

falemderoj për punët që keni bërë deri tani për mirëmbajtjen e shkollave. Dua t'ju falemderoj sepse u zgjidh problemi i fëmijëve të Rrërsit për transportin me fugon. Ne kemi problem me ngrohjen të shkollës “Mustafa Matohiti” sepse janë prishur kaldajat. Edhe dritat kanë probleme. Për sa i përket shkollës vartëse Ofinë kemi problem me ambientet e jashtme ndonjë stol dhe brenda janë disa tuba që duhen mbuluar sepse pengojnë fëmijët në ambientet e shkollës. Edhe dritaret fusin ujë dhe duhen mirëmbajtur.

Drejtor i ASHP, z. Eneo Xhaferaj- për pjesën e stolave janë pajisur disa shkolla si Muhamet Shehu, Hekuran Maneku, Zhani Ciko, shkolla Zharrëz. Të gjitha shkollat do pajisen me stola nga ndërmarrja. Edhe me kosha të vegjël do pajisen të gjitha shkollat.

Mësues në shkollën “Sotir Kola” Belinë, z. Mustafa Demiraj- unë dua të përcjell një problem me celularët në shkollë dhe përdorimin e tyre. Nxënësit nyk duhet të vijnë në shkollë me telefona. I del si detyrë që aparatit celular gta mbledh mësuesi kujdestar. A mendohet që të parashikohet një investim krahas këtij vendimi. A mund të pajisemi me një mobilie për të mbajtur telefonat? Duhet të bëhet dika pasi kjo ngelet në përgjegjësinë tonë.



**Mësues në shkollën “Sotir Kola”
Belinë
z. Mustafa Demiraj**

Dëgjuesë publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

Anëtare e Këshillit bashkiak, znj. Vjollca Kasaj- Unë dua të shtoj që shkolla në Belinë ka



**Anëtare e Këshillit bashkiak
znj. Vjollca Kasaj**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

një problem të madh me igrasinë dhe lagështirën. Të gjitha muret kanë lagështirë dhe duhet ndërhyrë për këtë problem.

Drejtor i ASHP, z. Eneo Xhaferaj- ky problem lidhet me pjesën e investimeve dhe duhet investuar me të gjithë shkollën ndaj do ta mbajmë si kërkesë të rregjistruar.

Drejtoresh e kopshtit nr. 2, znj. Flutura Kodheli- a do të ketë një investim për kopshtin nr.



**Drejtoresh e kopshtit nr. 2
znj. Flutura Kodheli**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-
2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

2 sepse kopshti nr. 1 është duke u rikonstruktuar tashmë Kopshti i Grizës është në një ambjent me qira dhe nuk është i mjaftueshëm si ambjent për dy grupe.

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli- kopshti nr. 2 është në fazë projektimi. Për sa i përket kopshtit Grizës nuk është gjetur një ambjent më i përshtatshëm pasi dhe thirrja është hapur disa herë dhe ka qëndruar e hapur, por nuk ka pasur asnjë ofertë tjetër më të mirë.



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-
2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

Mësues në shkollën “Koli Dimo frashër, z. Viktor Gjyla– ne kemi disa probleme me ambientet e shkollës jashtë dhe gjithashtu me bankat dhe karriget. Ato janë shumë të dëmtuara. Kemi problem dhe me fushën pasi unë jam trajnerë dhe stërvis disa fëmijë aty te



**Mësues në shkollën “Koli Dimo frashër
z. Viktor Gjyla**

Dëgjesë publike me temë:

**“Konsultimi i ndryshimeve të Paketës
Fiskale 2026 dhe rishikimi i
ndryshimeve të projekt dokumentit për
hartimin e PBA-së 2026-2028 dhe
buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

fusha, por duhen dy porta të vogla që ne të bëjmë stërvitjen. Në shkollë kemi nevojë edhe për ngrohje.

Drejtore i ASHP, znj. Eneo Xhaferaj- Lidhur me portat do ti bëjmë. Gjithashtu edhe me karriget dhe bankat do punojmë dhe do ti vendosim vida duke i riparuar. Nuk mund të sjellim të reja, por do riparojmë ato që janë.

Nxënëse në shkollën “Muhamet Shehu”, Enrika Xeba- përshëndetje! Në shkollën tonë



**Nxënëse në shkollën “Muhamet Shehu”
Enrika Xeba**

Dëgjesë publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

mungon një Smart Club dhe do të ishte shumë e nevojshme që edhe ne të kishim një klasë të tillë.

Zv/ Kryetare e bashkisë, znj. Ina Sauli- Ky lloj investimi për një Smart Club është pjesë e investimeve që bën Ministria e Arsimit. Pra drejtori i shkollës u drejtohet atyre me një kërkesë dhe ata ju ndihmojnë në ndërtimin e një klase të tillë pasi nuk është detyrim i bashkisë një investim i tillë.



**Zv/ Kryetare e bashkisë
znj. Ina Sauli**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

Anëtare e Këshillit Bashkiak, znj. Vjollca Kasaj- Te shkolla “Muhamet Shehu” ka nevojë për ndërhyrje edhe te pjesa e palestrës pasi ka një çarje vertikale.



**Anëtare e Këshillit Bashkiak
znj. Vjollca Kasaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

Mësuese në shkollën Ruzhdie, znj. Trëndelina Faslliaj- Në katin e dytë të shkollës ne kemi



**Mësuese në shkollën Ruzhdie
znj. Trëndelina Faslliaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së 2026-
2028 dhe buxhetit për vitin 2026”
Shtator 2025**

proble me përmbytjen pasi bie shiu i gjithë brenda. Gjithashtu edhe ujë në shkolla nuk kemi fare.

Drejtore i ASHP, z. Eneo Xhaferaj- do ta verifikojmë këtë problem dhe do të ndërhyjmë. Për shkollën në Erushdie ne do mundohemi të riparojmë sa mundemi që mos të kenë më problem me përmbytjen edhe pse është shumë e vështirë në ato kushte që është çatia.

Kryetar i Këshillit Bashkiak, z. Armand Ahmetaj- Nëse edhe të rinjtë nuk kanë ndonjë kërkesë unë do ta deklaroja të mbyllur këtë dëgjese publike të mbyllur.



**Kryetar i Këshillit Bashkiak
z. Armand Ahmetaj**

Dëgjese publike me temë:

**“Rishikimi i ndryshimeve të projekt
dokumentit për hartimin e PBA-së
2026-2028 dhe buxhetit për vitin 2026”**

Shtator 2025

Koordinator i Konsultimit Publik

Simela Shahinaj

Sekretar i Këshillit Bashkiak

Refaela Xeba